



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria Burimeve Njerëzore



Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksksh.com.al

KONTRATË

**ME MJEKUN SPECIALIST TË SPITALIT PËR PËRSHKRIMIN E BARNAVE QË
TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE**

Palët Kontraktuese:

Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor/ Drejtoria Rajonale e Fondit, më poshtë do të quhet **DSHSUKS/DRF**: përfaqësuar nga Z./Znj. _____, Drejtor/e i/e Drejtorisë,

Dhe

Z./Znj. _____, Mjek Specialist _____, në Shërbimin e _____, pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë/ Spital Rajonal/ Bashkiak, bien dakort dhe marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet për realizimin e kësaj kontrate.

Baza ligjore:

Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative";

Ligji Nr. 123/2014, datë 25.09.2014, "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë";

Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH Nr. 18, datë 31.03.2015, "Për tregtimin e disa barnave nga lista e barnave të rimbursuara në farmacitë e spitaleve";

Udhëzimi i FSDKSH Nr. 3, datë 11.11.2010, "Mbi kontrollin e spitalit që financohet nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", i ndryshuar;

Udhëzimi i FSDKSH Nr. 33, datë 26.12.2014, "Për Kartën e Shëndetit", i ndryshuar;

Rregullore e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 3, datë 22.10.2014, "Për procedurën dhe mënyrën e kontrollit të dhënësve të shërbimit të kontraktuar me Fondin";

Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 237, datë 07.06.2011, “Për miratimin e udhëzuesve të praktikave mjekësore e protokolleve të mjekimit”;

Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 460, datë 30.10.2015, “Për tregtimin e një bari nga lista e barnave të rimbursueshme nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor pranë farmacisë në Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’, Tiranë”;

Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 28, datë 26.01.2016, “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”;

Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 558, datë 26.10.2009, “Për regjistrimin, identifikimin dhe lëvizjen e pacientit brenda institucioneve shëndetësore në zbatim të sistemit të referimit”, i ndryshuar.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, kundrejt njohjes nga Fondi të së drejtës së plotësisimit të recetës me rimbursim, për barnat që tregtohen në farmacinë e Spitalit.

Neni 2

Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo kontratë është e vlefshme nga data e nënshkrimit deri më 31.12.2016. Ky afat mund të ndryshohet me miratimin e përbashkët të palëve.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve.

Neni 3

Detyrimet e Mjekut Specialist

A. Detyrime të përgjithshme

1. Të ofrojë shërbim shëndetësor të specializuar për diagnoza të veçanta dhe trajtimin me barnat të cilat tregtohen në farmacinë e Spitalit, të përshkruar në udhëzim të posaçëm.
2. Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen, në përputhje me Ligjin nr. 10 107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, Protokollat profesionale të miratuara, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, legjislacionin e Urdhrit të Mjekut, aktet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Fondit.
3. Të hapë kartelë klinike për të sëmurët që trajton dhe të plotësojë atë në të gjithë rubrikat e saj në bazë të urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 417, datë 14.07.2010, “Për miratimin e kartelës klinike të shtrimit në spital”, si dhe kartelat personale sipas specifikave të çdo shërbimi.

4. Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm mjekësor si kartelat, regjistrat dhe recetat me rimbursim.
5. Të kryejë vizitën falas kundrejt identifikimit të pacientëve nëpërmjet dokumentacionit identifikues dhe Kartës së Shëndetit.
6. Të pranojë kontrollin e strukturave kontrolluese të Fondit.
7. Të japë informacion Fondit/ DSHSUKS/ DRF për aktivitetin e tij, si të konsultës dhe plotësimin e recetës me rimbursim në lidhje me objektin e kësaj kontrate, sa herë që kërkohet.
8. Të zbatojë sistemin e referimit në shërbimet shëndetësore. Rekomandimet sipas sistemit të referimit do të kërkohen për fillimin e mjekimit dhe deri në mbarimin e ciklit të mjekimit ose periudhën e rikontrollit.
9. Të mos kërkojë nga i sëmuri asnjë shpërbllim tjetër.

B. Detyrime për përshkrimin e recetës me rimbursim

1. Të përshkruajë recetën me rimbursim për barnat që tregtohen në farmacinë e Spitalit, sipas listës së barnave të rimbursueshme, në zbatim të Udhëzimit përkatës të Fondit, për përshkrimin e barnave të cilat tregtohen në farmacinë e Spitalit.
2. Të plotësojë recetën me rimbursim në të gjithë elementët e saj dhe të pasqyrojë atë në kartelë klinike dhe në regjistrin e vizitave.
3. Të plotësojë recetën me rimbursim për të sëmurët në bazë të konsultës së shërbimit përkatës.
4. Të ruajë në kartelën e të sëmurit ekzaminimet që mbështesin diagnozën dhe përcaktojnë mjekimin.
5. Të përshkruajë në recetën me rimbursim, diagnozën dhe kodin e diagnozës, barin me emrin xhenerik.

Neni 4

Detyrimet e DSHSUKS/ DRF

1. Të pajisë Mjekun Specialist me listën e barnave, udhëzimet dhe protokollet e përdorimit të barnave si dhe dokumentacionin e nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tij në zbatim të kontratës, si dhe të sqarojë atë për çdo paqartësi lidhur me të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate.
2. Të kontrollojë aktivitetin e Mjekut Specialist dhe të verifikojë të gjithë rastet e konfirmuara nga konsulta e shërbimit përkatës.
3. Të regjistrojë dhe të vulosë recetat e lëshuara nga Mjeku Specialist.
4. Të marrë informacionin e nevojshëm dhe të analizojë shpenzimet e rimbursimit për secilin shërbim.

Neni 5

Sanksionet

1. Kushti penal

Ndaj Mjekut Specialist merret masa e kushtit penal si më poshtë:

1. Për mos plotësim të elementeve të veçantë të kartelës klinike, regjistrit të vizitave, regjistrit të konsultave dhe të recetës, merret masa e kushtit penal në vlerën 1000 lekë për secilin rast.
2. Për mos plotësim të kartelës klinike, të regjistrit të vizitave, regjistrit të konsultës merret masa e kushtit penal në vlerën 5000 lekë.

2. Dëmi ekonomik

Mjeku Specialist detyrohet të zhvendosë vlerën e dëmit ekonomik kur gjatë kontrollit të strukturave të Fondit/ DSHSUKS/ DRF, konstatohet se:

1. Jep nëpërmjet recetës me rimbursim barin që i sëmuri nuk e gëzon me aktet që burojnë nga ligji i sigurimeve shëndetësore.
2. Trajton të sëmurin me recetë të rimbursueshme, kur doza apo veprimi terapeutik i barit nuk përputhet me: diagnozën ose jepet në kundërshtim me kufizimet e listës së barnave të rimbursueshme dhe protokollin e përdorimit të barit.
3. Përshkruan barnat në recetën me rimbursim në sasi dhe dozë më shumë se përcaktimi i konsultës.
4. Në rastin kur vërtetohet lëshimi i recetës fiktive (sipas përcaktimit të pikës nr. 2, tek ndërprerja e kontratës).

3. Ndërprerja e Kontratës

Kontrata ndërpritet para afatit të vlefshmërisë kur Mjeku Specialist:

1. Nuk pranon pa arsye kontrollin e Fondit.
2. Lëshon recetë fiktive me qëllim përfitimi për vete ose në favor të tretëve. Recetë fiktive quhet receta e dhënë:
 - Në emër të personave që nuk jetojnë;
 - Personave të rremë;
 - Personave që nuk kanë dijeni për lëshimin e saj dhe nuk e kanë përfituar këtë bar;Në këto raste mjeku duhet të zhvendosë vlerën e dëmit ekonomik që i ka shkaktuar sigurimeve shëndetësore, si dhe bëhet kallëzim penal.
3. Është përjashtuar nga Urdhri i Mjekut.
4. Është dënuar me vendim Gjykatë që i kufizon të drejtën e ushtrimit të profesionit.
5. Nuk i përgjigjet detyrimeve kontraktuale në mënyrë të përsëritur dhe pa shkaqe të pranueshme.

Neni 6
Procedura e ankimit

1. Personi përgjegjës për shkeljen e konstatuar ka të drejtën e ankimit kundrejt sanksioneve të vendosura nga FONDI/ DSHSUKS (kushte penale, dëme ekonomike apo ndërprerje kontrate) pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit me masat përkatëse. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit pranë sekretarisë së tij.
2. Kundër vendimit të Komitetit subjektet mund të ankohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Neni 7
Dispozitat e fundit

1. Palët kontraktuese, të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kësaj kontrate, do t'i zgjidhin me marrëveshje. Në rast se nuk mund të arrihet marrëveshja, palët kontraktuese i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Ndryshimet e kontratës brenda vitit bëhen me shtesë kontrate me shkrim, kur të 2 (dy) palët kontraktuese bien dakord.

Kjo kontratë u nënshkrua në _____, më datë _____ nga palët kontraktuese:

DSHSUKS/DRF

MJEKU SPECIALIST
